STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 19 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE NDIHMA PER PAPUNESINE PREJ KATASTROFES TANI ESHTE E DISPONUESHME NE QARQE TE TJERA

Të papunët në qarqet Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulster (Ulster) mund të bëjnë kërkesë tani për ndihmë për katastrofën

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se ndihma federale e papunësisë prej katastrofës (DUA) është tani e disponueshme për banorët e qarqeve Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulster (Ulster) që humbën vendet e punës ose të ardhurat e tyre për shkak të Uraganit Sendi (Sandy).

Përfitimet e papunësisë prej katastrofës janë të disponueshme për të siguruar ndihmë financiare për këdo që humbi vendin e tij të punës dhe jeton ose punon në qarqet Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk), Sallivën (Sullivan), Ulstër (Ulster) dhe Uestçester (Westchester).

"Kjo ndihmë jetësore do të ndihmojë banorët e Nju Jorkut që humbën vendet e tyre të punës si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy) që të rindërtojnë jetën e tyre," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Do të vazhdojmë të bëjmë gjithshka që mundemi për të ndihmuar ata që janë prekur nga pasojat katastrofike të Uraganit Sendi (Sandy) dhe jam i kënaqur që banorët në qarqe të tjera tani do të kenë të drejtë për këtë ndihmë federale."

Javën e kaluar, Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi një zgjatje nga 3 dhjetor 2012 deri më 4 shkurt 2013 për të bërë kërkesë për (DUA). Kërkuesit kanë deri në 90 ditë për të paraqitur provën e punësimit ose të vetë-punësimit dhe do t'u sigurohet një lidhje e IRS-së për të përshpejtuar rimarrjen e dokumentave të taksave të humbura ose të shkatërruara.

Kjo ndihmë i shtohet sistemit ekzistues të sigurimit për papunësinë të Nju Jorkut dhe zgjeron të drejtat për të përfshirë individë që përndryshe nuk do të mbuloheshin. Qeveria Federale është përkushtuar të sigurojë ndihmë shtesë ndërsa identifikohet kërkesa për këto shërbime.

Që kur u njoftua ndihma DUA, Departamenti i Punës ka marë më shumë se 27,500 telefonata në lidhje me papunësinë prej katastrofës. Më shumë se 4,600 individë kanë bërë kërkesë për ndihmë për papunësinë prej katastrofës dhe mbi 18,100 kanë bërë kërkesë për Përfitimet e rregullta të Papunësisë duke rezultuar nga stuhia.

Kushdo që është i papunë si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy) mund të paraqesë një pretendim në Departamentin e Punës. Kriteri për marrjen e ndihmës për katastrofën është më i gjerë sesa për marrjen e përfitimeve të rregullta të papunësisë. Veçanërisht, një individ mund të marë ndihmë për katastrofën në ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

- I plagosur gjatë katastrofës dhe jo në gjendje për të punuar, pavarësisht nëse personi është një punonjës ose i vetë-punësuar.
- Vendi i punës është dëmtuar ose shkatërruar ose personi nuk mund të punojë për shkak të katastrofës.
- Transporti për në punë nuk është i disponueshëm për shkak të katastrofës.
- Nuk mund të shkojë në punë sepse duhet të udhëtojnë përmes zonës së prekur, gjë që është e pamundur për shkak të katastrofës.
- Eshtë planifikuar të fillojë të punojë, por nuk mundet për shkak të katastrofës.
- Mori pjesën më të madhe të të ardhurave nga zonat e prekura nga katastrofa dhe biznesi është mbyllur ose jo në funksionim për shkak të katastrofës.
- Nuk ka të drejtë përndryshe për përfitime të rregullta të papunësisë.

Megjithatë, kjo listë nuk është e plotë dhe nëse dikush është i pasigurtë në lidhje me të drejtën, ai ose ajo inkurajohet që të bëjë kërkesë. Të gjithë kërkuesve do t'u kërkohet të paraqesin informacionin mbi pagën dhe dokumentacionin që mbështet kërkesën e tyre.

Shembuj të vetë-punësimit përfshijnë pronarë të bizneseve të vegjël, shoferë të pavarur të taksive, shitësa, peshkatarë tregtarë të pavarur dhe fermerë.

Komisioneri i Departamentit të Shtetit të Punës Pitër M. Rivera tha, "Humbja e shtëpisë suaj ose të shihni që pasuria juaj është shkatërruar është mjaft e keqe, por humbja e vendit tuaj të punës e bën një gjendje si ajo edhe shumë më keq. Jam i kënaqur që mund t'ju japim këtë ndihmë më shumë banorëve të Nju Jorkut në nevojë."

Për të bërë kërkesë për përfitimet e papunësisë ose të ndihmës së papunësisë prej katastrofës, ata që janë prekur nga stuhia dhe kanë humbur vendet e punës ose të ardhurat e tyre duhet t'i telefonojnë Qendrës së Pretendimeve Telefonike (TCC) në 1-888-209-8124 ose 1-877-358-5306 nëse jetojnë jashtë shtetit. Kërkuesit duhet t'u përgjigjen pyetjeve për të treguar se humbën punën e tyre për shkak të Uraganit Sendi (Sandy). Në mënyrë që të merrni përfitime duhet të bëni kërkesë deri më 4 shkurt 2013.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418